



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12588 prot.

Vlorë, më 18.10 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____ 2023

“Për një ndryshim ne V.K.B nr.32 date 31.03.2023

“ Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të shoqërisë K.F Oriku”

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative të republikës së Shqipërisë, neni 22 pika 2 dhe neni 113, në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9 pika 1.1/b dhe d, neni 25 pika 4, dhe neni 64 pika a dhe f, në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’, neni 135, pika 2/c dhe 4, ne Statutin e Shoqërisë, neni 21, si edhe në kërkesën e paraqitur nga Administratori i klubit K.F.Oriku

VENDOSI:

1. Të saktësohet pika 1, konkretisht:

Të rinovohet mandati si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të K.F.Oriku për një afat 3 vjecar për anëtarët :

- a) Agim Begotaraj
- b) Arsen Belaj

2. Ky Projekt- Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETARI

Ermal Dredha

Konceptoi: S.Kalemi

Miratoi: D.Demiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12588 prot.

Vlore, më 18.10 2023

LENDA: Relacion mbi një ndryshim ne V.K.B nr.32 date 31.03.2023 “Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të shoqërisë K.F Oriku”

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim per miratim “Mbi një ndryshim ne V.K.B nr.32 datë 31.03.2023 “Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të shoqërisë K.F Oriku”, konsiston ne kerkesen nr.Prot 43, datë 21.09.2023, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.11271 Prot, datë 22.09.2023 ku kerkohet saktesimi i rinovimit të afatit per anetaret e Keshillit Mbikqyrës të K.F.Oriku sh.a nga Administratori i i Klubit Z.Muharrem Lazaj.

Me Vendimin nr.32 date 31.03.2023 nga Këshilli i Bashkisë Vlorë është miratuar Projekt - Vendim “Per rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të shoqërisë K.F Oriku”, konkretisht pika 1 ku eshte rinovuar mandati si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të K.F.Oriku per nje afat 4 vjecar per anetaret:

- 1) Agim Begotaraj
- 2) Arsen Balaj


Duke u bazuar ne statutin e shoqerisë aksionare te K.F.Oriku sh.a , Neni 21 theksohet se anetaret e Keshillit Mbikqyrës kane nje mandat 3 (tre) vjecar me te drejte rizgjedhje, kerkojme prej jush miratimin e ketij Projekt-Vendimi duke saktësuar afatin nga 4 (katër) vjecar ne 3 (tre) vjecar.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

KRYETARI

Ermal Dredha

Konceptoi:S.Kalemi
Miratoi:D.Demiri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues L. F. Duka Vl., Nr. Prot. 43, Data 21.09.2023
Shkurtimi i lëndës Rivokim afat

Për trajtim nga:	<u>D. Jav.</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afati: Normal 7 ditë/ Prioritet 3 ditë/ Urgjent brenda ditës/ Pa afat/Për dijeni/Tjetër ___ ditë

Data 22.09. 2023, Nr. Prot. 11271 Nënshkrimi: (TITULLARI) [Signature]

Marrë në dorëzim: 28.09. 2023 Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ .2023

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ .2023 Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ .2023

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ .2023 Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____ .2023

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____ 2023 Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____ 2023 Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____ 2023 Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____ 2023 Eprori në shkallë hierarkike



11271
22.09.2023

K.F ORIKU

Nr. 43 Prot

Orikum, 21 / 09 / 2023

Drejtuar : Keshillit Bashkiak , Vlore

Lënda : Rinovim afati per anetaret e Keshillit Mbikqyres se K.F Oriku sh.a

KERKESE

Subjekti K.F Oriku sh.a, me Nuis L36521202N, me ane te kesaj shkrese, kerkon nga institucioni juaj, rinovimin e afatit te anetareve te Keshillit Mbikqyres se subjektit tone, z.Agim Begotaraj dhe z.Arsen Belaj, pasi afati i emerimit te tyre ka mbaruar me date 12 Shtator 2022.

Subjekti yne ka bere dhe me perpara kerkese per kete ceshtje dhe Keshilli Bashkiak me vendimin nr 32, date 31.03.2023 me Nr 3968/1 Prot, date 06.04.2023 ka vendosur t'ia rinovoj mandatin si anetare te Keshillit Mbikqyres per nje afat 4 (kater) vjecar. Por, bazuar ne statutin e shoqerise aksionare te K.F Oriku sh.a, Neni 21, thuhet se anetaret e Keshillit Mbikqyres kane nje mandat 3 (tre) vjecar me te drejte rizgjedhje.

Per kete arsye, Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), ka pezulluar vazhdimisht aplikimet qe ne kemi bere.

Bazuar ne sa me siper, duke ju falenderuar per bashkepunimin, do te jemi ne pritje te nje vendimi te ri ku te cilesohen emrat e anetareve dhe kohezgjatja e mandatit prej 3 (tre) vjetesh, si dhe vendimi i ri te mos permbaje dy data (si ne rastin e vendimit te vjeter, pra data 31.03.2023 dhe 06.04.2023) por te jene te unifikuara brenda ne shkresen qe do te dergoni (te jete nje date e vetme shkresa), pasi dhe kjo ishte nje ceshtje tjeter per te cilen QKB pezullonte kete vendim qe ju kishit marre.

Bashkengjitur po ju nisim dhe vendimin e institucionit tuaj per ta ripare serisht.

Theksojme faktin qe per kete ceshje ju kemi derguar shkrese me date 16.08.2023 me Nr 37 Prot.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin, jemi ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj !

Administrator klubi

Muharrem Jazaj



Ad : Vlore, Orikum, Lagjia " 1 Maji " , Rruga " Bulevardi Princesha Rujgine " e-mail: kf.oriku@hotmail.com
cel 0682065718


ORIGJINALI NDODHET NE
RKIVENE BASHKISE VLORE



DATE E 24/04/2023 REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3968/1 prof.



Vlorë, më 06.04.2023

VENDIM

Nr. 32 . Datë. 31.3.2023

“Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të shoqërisë K.F
Oriku”

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative të republikës së Shqipërisë, neni 22 pika 2 dhe neni 113, në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9 pika 1.1/b dhe d, neni 25 pika 4, dhe neni 64 pika a dhe f, në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 135, pika 2-c dhe 4, si edhe në kërkesën e paraqitur nga Administratori i klubit K.F.Oriku

VENDOSI:

1. Të rinovohet mandati si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të K.F.Oriku për një afat 4 vjeçar për anëtarët :
 - a) Agim Begotaraj
 - b) Arsen Belaj
2. Ky Projekt- Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETARE

Migena Balla

